



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ  
Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT  
O M B U D S M A N  
Republic of Macedonia

Mekanizmi Parandalues Nacional më datë 23-24.11.2017 realizoi vizitë të paparalajmëruar për rikontroll në Burgun Strumicë. Vizita u realizua në kuadër të mandatit dhe kompetencave të cilat burojnë nga Protokollin Fakultativ ndaj Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese dhe Ligji për Avokatin e Popullit.

Mekanizmi Parandalues Nacional vizitën në Burgun Strumicë e realizoi përmes disa hapave, në përputhje me Metodologjinë për zbatimin e parandalimit nga tortura dhe llojeve të tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Ekipi i MPN-së hasi në bashkëpunim dhe kooperativitet të mirë nga ana e personave zyrtarë, të punësuar në Burgun Strumicë, i cili mundësoi qasje papengesë në të gjitha hapësirat dhe instalimet dhe këqyrje mbi dokumentacionin e kërkuar. Në momentin e vizitës, në Burgun Strumicë kishte gjithsej 85 persona të cilët e vuanin dënimin me burgim, ndërkaq 17 persona ishin në arrati.

Gjatë kohës së vizitës në Burgun Strumicë, Ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional vëmendje të veçantë u përkushtoi kushteve materiale në këtë institucion ndëshkues-korrektues dhe të gjitha kapaciteteve të vendosjes, bashkë me hapësirat e tjera të jashtme plotësuese.

Burgu Strumicë nuk disponon me hapësira të veçanta për pranimin e personave të dënuar (Reparti i pranimit), e as hapësirë për zbatimin e kontrollit të personave të dënuar gjatë pranimit në Institucion. Nga bisedat e zhvilluara me personat e dënuar dhe me personat zyrtarë, u konstatua se vazhdon praktika që personat e sapo-pranuar, për një periudhë të caktuar të vendosen në hapësirat e izolimit/qelive, para se të vendosen në hapësirat e repartit përkatës – të hapur ose gjysmë të hapur. Mekanizmi Parandalues Nacional sugjeron se mënyra e këtillë e vendosjes së kategorive të ndryshme të personave të dënuar në hapësirat për izolim (personat e sapo-pranuar dhe personat të cilët e vuajnë masën disiplinore-referim në qeli) çon deri në infeksionin e mundshëm kriminogjen, me çka ekziston mundësia për zvogëlimin e rezultatit/qëllimit të fundit të vendosjes në këtë pjesë të Burgut.

Ekipi i MPN-së, gjatë kohës së vizitës zhvilloi biseda individuale dhe grupe me më shumë persona të dënuar, të cilët kishin për qëllim hetimin e veprimit, përkatësisht trajtimin e personave zyrtarë ndaj personave të dënuar, si dhe përcaktimin e shkallës së respektimit të të drejtave të personave të dënuar.

Numri më i madh i personave të dënuar, sjelljen e personave zyrtarë e vlerësuar si të mirë dhe korrekte, megjithatë, kishte një pjesë të personave të dënuar të cilët potencuan se ndodh që përfaqësuesit e policisë së burgut të sillen në mënyrë arrogante dhe ofenduese ndaj tyre, madje edhe të përdorin forcë fizike, duke u rënë “shuplaka ose bokse” nëpër pjesë të ndryshme të trupit. Disa nga personat e dënuar thanë se, shpeshherë nëpunësit zyrtarë të

policisë së burgut përdorin forcë fizike mbi personat e dënuar të cilët e vuajnë dënimin disiplinor - izolim.

Po ashtu, gjatë kohës derisa gjenden në izolim ka pasur raste kur disa persona të dënuar, sipas tyre, për shkaqe nga më të ndryshme banale (për shembull, rënies më të gjatë të ziles për thirrje ose për shkak të trokitjes në dyer nga qelitë, në rastet kur personat zyrtarë ndoshta nuk e kanë dëgjuar zilen) të rrihen nga nëpunësit policorë, kinse për t'i qetësuar, ndërsa një gjë e këtillë më së shpeshti ndodh me ndarjen e personit në njërën nga qelitë, jashtë syve të personave të tjerë të dënuar të cilët për momentin, gjithashtu, e vuajnë dënimin disiplinor - izolim.

Ekipi i MPN-së shpreh shqetësim serioz lidhur me të dhënat e këtilla, veçanërisht për faktin se nga ana e personave zyrtarë u mor informata se nga instalimi i video mbikëqyrjes në Institucion nuk punojnë kamerat e instaluara pikërisht në pjesën e qelive. Në këtë kuptim, Ekipi i MPN-së sugjeron se ndalohet çdo formë e torturës ose trajtimit nënçmues dhe ndëshkues dhe se është e nevojshme personat zyrtarë, gjatë sjelljes me personat e dënuar, ta respektojnë plotësisht integritetin e tyre dhe personalitetin njerëzor dhe ta mbrojnë integritetin e tyre psikofizik dhe moral, ndërsa drejtoria e Burgut t'i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për t'i hetuar të dhënat dhe informacionet për sjellje eventuale jopërkatese të personave zyrtarë. Gjithashtu, është e nevojshme drejtoria e Burgut të ndërmerr masa dhe aktivitete konkrete, me të cilat do t'i inkurajonte personat e dënuar t'i denoncojnë rastet e trajtimit joadekuat të personave zyrtarë ndaj tyre.

Personat zyrtarë, gjithashtu, u ankuan edhe për numrin e vogël të të punësuarve, në raport me personat e dënuar të cilët e vuajnë dënimin me burgim. Së këtejmi, nga bisedat, ndërkaq në mënyrë evidente edhe nga këqyrja e listave të të punësuarve në Burg, INK Burgu Strumicë vërehet mungesa e kuadrit të gjinisë femërore edhe atë konkretisht në Sektorin e sigurisë, e që çon deri në gjendje që kontrolli i parashikuar mbi personat femra, të cilat vijnë në vizitë tek i burgosuri, të mos zbatohet fare, e që nga ana tjetër e vë në pikëpyetje sigurinë e Institucionit.

Sipas informatave të fituara për përdorimin tejmase të mundshëm të forcës dhe shkaktimin e lëndimeve trupore nga ana e policisë së burgut mbi një person të dënuar, Ekipi i MPN-së bashkë me bashkëpunëtorët e jashtëm, gjatë kohës së vizitës, ndërmori aktiviteteve për hetimin e plotë të rastit.

Në këtë kontekst, nga ana e bashkëpunëtorëve të jashtëm neuropsikiatrit dhe specialistit për mjekësi psikologjike u krye kontrolli psikiatrik dhe testimi psikologjik i personit të dënuar, ndërsa u bë edhe këqyrje mbi dokumentacionin mjekësor, përkatësisht kartonin shëndetësor të personit të dënuar. Nga ana e bashkëpunëtorit të jashtëm foreznic u krye dhe kontrolli fizik, ndërsa nga ana e anëtarëve të Ekipit të MPN-së u zbatua këqyrje në librin për evidencë të përdorimit të mjeteve të forcës dhe u zhvilluan më shumë biseda me personat e dënuar, në lidhje me rastin konkret.

Bashkëpunëtorët e jashtëm, pas ekzaminimit të plotë psikiatrik dhe testimit gjithëpërfshirës psikologjik klinik, konstatuan se bëhet fjalë për person të strukturuar psikopatik (çrregullim i personalitetit), tek i cili është shkaktuar dekompensim me dominim të sjelljes agresive dhe destruktive, në momentin e kontrollit apsikotik. Rekomandimi i

bashkëpunëtorëve të jashtëm, drejtuar personelit mjekësor të Burgut, është të vazhdoj me terapinë psikiatrike dhe ndjekje të kohëpaskohshme psikiatrike (kontrolle).

Nga ana tjetër, nga kontrolli i kryer i mjekut foreznik u konstatua se në ditën e vizitës nuk kishte lëndime fizike. Ekipi i MPN-së zhvilloi bisedë edhe me një numër të madh të personave të dënuar të cilët potencuan se bëhet fjalë për person i cili ka prirje për sjellje agresive-destruktive dhe vetë-lëndim.

Si rezultati i vizitës së realizuar, Mekanizmi Parandalues Nacional përpiloi raport të posaçëm, në të cilin i konstatoi gjendjet dhe dha rekomandime përkatëse të cilat ia dërgoi Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe drejtorit të Burgut Strumicë, me qëllim të eliminimit të rreziqeve dhe mangësive.